

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Jeta mes botimeve dhe shkencës/ Historiani Aurel Plasari feston 70-vjetorin e lindjes
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/jeta-mes-botimeve-dhe-shkences-historiani-aurel-plasari-feston-70-te--i474297
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 07:34:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	59611952cfcc4f4b48d5e72d5b96a53b77f624b74f37e3fd16f44fab36e12616
TEKSTI	d8f53f921a7eadbe1802949ce3695b793b4bda742b0ee689144bd27431c75572
PAMJA	663f921c8e73ff9f38849bf1012989a2ad90458238bef0ecb66cfd0a9d7d9b49

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5fd7cc6b1827014b20047c5832f053970f2f7a03191cb4d2f1fcd76287277b99
E MËPARSHMJA	6c20bbf1e69ef1187c5d6586549b651d5c8f9fd1a4fdfa76bc0150f9d7e6e5a4
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5fd7cc6b1827014b20047c5832f053970f2f7a03191cb4d2f1fcd76287277b99>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

09:57 Politikë

Kryeministri Edi Rama ka mbërritur paraditen e sotme në qy...

Jeta mes botimeve dhe shkencës/ Historiani Aurel Plasari feston 70-vjetorin e lindjes



16 Shtator 2026, 09:31, Aktualitet CNA



Historiani dhe profesori i njohur, Aurel Plasari, feston sot ditëlindjen e tij të 70-të.

Me një veprimtari prej pesë dekadash, Plasari njihet për kontributin e tij në fushën e historisë, në veprimtari shkencore-akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe përkthime e botime të ndryshme.

Plasari u lind më 16 shtator 1956 në Tiranë, ku edhe ka kryer të gjitha nivelet e arsimit.

Ka filluar të botojë përkthime nga letërsia botërore në shtypin letrar qysh në moshën 17-vjeçare gjatë viteve të shkollës së mesme ("Nëntori", nr. 3, 1973).

Pas shkollimit të mesëm ka kryer shërbimin e detyruar ushtarak dhe, duke qenë se për disa vite i mohohej e drejta e studimeve të larta për shkaqe "biografie", e ka filluar punën në nivelet më të thjeshta të shtypit, si korrektor në shtypshkronjën "Mihal Duri".

Nga viti 1982 ka punuar korrektor letrar në revistën "Nëntori", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, prej 1989 redaktor i letërsisë së përkthyer po aty, ndërsa nga 1990 sekretar i Kolegjiumit të redaksisë në po të njëjtën revistë.

Studimet e larta i ka përfunduar më 1989 në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, dhe prej vitit 1990 u ftua si pedagog i jashtëm në të njëjtin Fakultet ku kishte kryer studimet. Pasi kreu më 1991 një specializim të shkurtër pasuniversitar në Universitetin "Alcalá" të Madridit (Spanjë), më 1992 u angazhua si pedagog ordinar në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, UT, ku ka kryer edhe detyrën e zv.dekanit.



Prej vitit 1996 ka vijuar detyrën në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, UT, për t'u shkëputur më 1998, kur është ftuar të drejtojë Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Në Masterin e Nivelit të Dytë të Shkencës së Bibliotekave, organizuar për herë të parë në sistemin arsimor shqiptar, ka dhënë lëndën e rikonceptuar "Hyrje në albanologji". Ndërsa më 1995 kishte kryer habilitacionin për "Profesor i asociuar", prej vitit 2010 mban titullin "Profesor".

Ka mbajtur detyrën e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe më tej vijoi si punonjës shkencor në Akademinë e Studimeve Albanologjike (ASA).





Nga 1990 deri më sot ka marrë pjesë në veprimtari shkencore-akademike kombëtare dhe ndërkombëtare: në USA, Kosovë, Itali, Francë, Spanjë, Ruman, Greqi, Austri, Bullgari, Poloni, Hungari, Çekosllovakia, FYROM etj.

Ka kontribuar paralelisht edhe si: anëtar i redaksisë së revistës "Filologji", organ i Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, 2019 - vijim; anëtar i bordit shkencor të revistës "Albanian Studies", organ i Akademisë së Studimeve Albanologjike, 2018 - vijim; anëtar i redaksisë së revistës "Studime Historike", organ i Institutit të Historisë, ASA, 2018 - vijim; anëtar i Këshillit Shkencor të Muzeut Historik Kombëtar, 2008-2013; anëtar i Komitetit Ndërmëditor të 100-vjetorit të Pavarësisë, 2011-2012; anëtar i Këshillit të Lartë të Arkivave, 1998-2005; drejtor nderi i Institutit të Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta", 1999-2005; kryeredaktor i edicionit të ri të revistës "Hylli i Dritës", 1993-1997; nënkryetar i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s, 1993-1995 etj.

Ka qenë dhe vijon të jetë i pranishëm në shtypin e lirë shqiptar.

Nga 1990 disa përmbledhje autorësh në zë të traditës, si Fishta, Merxhani, Harapi, Beduli etj., janë përgatitur prej tij, po ashtu ka qenë drejtuar prej tij kolana "Intelligenda" (shtëpia botuese "55"), me kontribues të albano-balkanologjisë, si Çelebi, Jorga, Jirecek, Gelchic, Suliotti, Londres, Konica, Zakythnos, Nadin, Xhufi etj. Në fushën e veprimtarive të kulturës ka drejtuar disa juri kombëtare, si dhe ka marrë pjesë si anëtar në juri kombëtare dhe ndërkombëtare.

Më 12 dhjetor 2025, Aurel Plasari i dekorua si Oficeri i Madh në "Urdhrin Suprem të Shqiponjës", si një vlerësim për kontributin 50-vjeçar në vend.

10:05 | 16 shtator

CNA.AL **EDITORIAL NGA ELVI FUNDO**

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar


Informohu tani!
cna.al
Pacensurë!

shëndeti

Truri mund të ndryshojë funksionimin e tij pas një dëmtimi, duke përdorur pjesërisht zona të tjera

MOTI SOT

PËRMET: 13° / 21°





Të sugjeruara

SHBA vlerëson punën e SPAK/ Lawton: Ka qenë efektive

Nesër është një ditë e veçantë!

Dita e 108/ Protestuesit shkojnë te "Mine Peza"

Foto/ Protestuesit në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Zbulohet skenari i protestuesve/ Çfarë do të ndodhë të enjten?

Akuzat për dajën e saj/ Zegjine Çausi thyen heshtjen

"Nuk e harrojmë Ardit Gjoklajn"/ Protestuesi: Hajdut e zvarranik si Veliaj, s'ka parë
Tirana

"Prania Besnike shfaqje në letra"/ Muçollari: Daja i Zegjinesë abuzoi me 34-vjeçaren për
një vend pune

"Drama e Roskovecit"/ Këlliçi: Zegjineja, nën akuzë për veprën penale të moskallëzimit të krimit

108 ditë proteste/ Qytetarët drejt Kryeministrit

Pse vetëm Erion Veliaj?

U kërcënua me jetë/ Gazetari Stafa tregon mesazhin që iu dërgua

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.